



Në bazë të Nenit 3 të Rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurën e ndarjes së mjeteve financiare për mbështetjen e projekteve dhe aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve me interes për Qytetin e Shkupit nr. 08-2378/1 datë 23.02.2026, dhe në lidhje me Programin e aktiviteteve të Qytetit të Shkupit për bashkëpunim me shoqatat dhe fondacionet në vitin 2026 ("Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 14/25), Qyteti i Shkupit shpall

**THIRRJE PUBLIKE**  
**për ndarjen e mjeteve financiare për mbështetjen e e projekteve dhe**  
**aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve të cilat kryejnë**  
**veprimtari me interes publik dhe që mbahen në territorin e Qytetit të Shkupit**

**1. Lënda e Thirrjes publike:**

1.1 Lënda e thirrjes publike është ndarja e mjeteve financiare për mbështetjen e projekteve dhe aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve që kryejnë veprimtari me interes publik dhe që mbahen në territorin e Qytetit të Shkupit..

1.2 Mjetet financiare janë siguruar nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2026, Programi i aktiviteteve të Qytetit të Shkupit për bashkëpunim me shoqata dhe fondacione në vitin 2026 në shumë prej 4.000.000,00 denarë.

1.3 Ndarja e mjeteve financiare përcaktohet në Rregulloren për mënyrën, kriteret dhe procedurën e ndarjes së mjeteve financiare për mbështetjen e projekteve dhe aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve me interes për Qytetin e Shkupit.

**2. Projekte të cilat do të mbështeten:**

2.1 Transferta për organizatat joqeveritare për realizimin e projekteve me interes për Qytetin e Shkupit do të orientohet drejt financimit të iniciativave të projekteve dhe aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve, përmes grandeve në fushat e mëposhtme prioritare:

- Mbështetje e projekteve për të rritur ndërgjegjësimin përmes fushatave dhe llojeve të tjera të iniciativave (aksione lokale) për: përdorimin e transportit publik nga qytetarët, përdorimin e biçikletave si mjet transporti, rritjen e ndërgjegjësimit për higjienën publike, mënyrat e ngrohjes së amvisërive dhe kursimet përmes masave të efikasitetit energjetik.
- Mbështetje për projekte në fushën e përmirësimit të mjedisit jetësor (ajri, uji, ndotja e tokës, hapësirat e gjelbra publike, përdorimi i burimeve rinovuese të energjisë, etj.) dhe zbutja e efekteve të ndryshimeve klimatike.

- Bashkëfinancim i projekteve të financuara nga programet evropiane, donatorë ndërkombëtarë dhe rajonalë, të cilat janë në kompetencë dhe interes të Qytetit të Shkupit.

Shuma totale: 3.000.000,00 denarë

2.2. Mbështetje e manifestimeve përmes grave në fushat e mëposhtme prioritare:

- Mbështetje e manifestimeve që lidhen me mbrojtjen e mjedisit jetësor;
- Mbështetje e manifestimeve për të shënuar ditët në fushën e kujdesit shëndetësor;
- Mbështetje e manifestimeve dhe eventeve me rëndësi për Qytetin e Shkupit, duke përfshirë aktivitetet që lidhen me përgatitjet dhe realizimin e Programit "Shkupi 2028 - Kryeqyteti Evropian i Kulturës", në partneritet me organizatat e shoqërisë civile, institucionet kulturore dhe komunitetin lokal.

Shuma totale: 1.000.000,00 denarë

### **3. E drejta për pjesëmarrje në Thirrjen publike:**

Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrjen Publike kanë shoqatat dhe fondacionet që kryejnë veprimtari me interes publik dhe janë të regjistruara në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut me seli në Shkup.

### **4. Kriteret bazë:**

Kriteret bazë që duhet të plotësojnë aplikantët që marrin pjesë në këtë Thirrje Publike janë:

- Të jenë regjistruar për kryerjen e aktiviteteve me interes publik në përputhje me Ligjin për Shoqatat dhe Fondacionet, me seli në Shkup;
- Të depozitojnë deklaratë të noterizuar ku deklarojnë se nuk kanë marrë mjete financiare ose nuk kanë depozituar kërkesë pranë ndonjë personi tjetër juridik për të njëjtin qëllim dhe aktivitete për të cilat depozitohet kërkesa.

### **5. Dokumentacioni i detyrueshëm për aplikim:**

- Fletëparaqitje/aplikim i plotësuar, i nënshkruar dhe i vulosur nga personi i autorizuar i aplikantit (kërkesa do të shpallet në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk));
- Formulari i plotësuar i propozimit - projektit (në dispozicion në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk));
- Statuti i aplikantit - shoqatë/fondacion;
- Kopje e Aktvendimit për regjistrim në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Kopje e Gjendjes aktuale për veprimtarinë e regjistruar jo më të vjetër se gjashtë muaj, e lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Kopja e llogarisë përfundimtare për vitin e kaluar fiskal;

- Vërtetim për llogari bankare të hapur dhe aktive;
- Vërtetim për tatime të paguara të lëshuar nga organet tatimore

#### **6. Dokumentacioni shoqëruar për aplikim:**

- Biografi profesionale e ekspertëve që do të angazhohen në realizimin e projektit;
- Mbështetje me shkrim nga organizata dhe/ose institucione të tjera që janë planifikuar të marrin pjesë në zbatimin e projektit.

#### **7. Kriteria të veçanta për përzgjedhjen e aplikantëve:**

7.1 Kriteret e veçanta për përzgjedhjen e aplikantëve janë parashikuar në Rregulloren për mënyrën, kriteret dhe procedurën e ndarjes së mjeteve financiare për mbështetjen e projekteve dhe aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve me interes për Qytetin e Shkupit, e cila është shpallur në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit ([www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk)).

#### **8. Mënyra e zbatimit të Thirrjes publike:**

8.1. Vlerësimi i aplikimeve, përkatësisht vlerësimi i cilësisë së projekteve dhe aktiviteteve programore të aplikantëve të interesuar që plotësojnë kriteret, si dhe vlerësimi i propozimeve të projekteve, do të kryhet nga Komisioni për projekte dhe aktivitete programore të shoqatave dhe fondacioneve me interes për Qytetin e Shkupit, i formuar nga Kryetari i Qytetit të Shkupit.

8.2. Aplikimet e depozituara jo në kohë, të parregullta (të palexueshme) ose të paplota dhe që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret, Komisioni do t'i refuzojë me Konkluzion dhe të njëjtat nuk do t'i shqyrtojë, gjë për të cilën do të njoftojë aplikantët, aplikimet e të cilëve janë refuzuar.

8.3. Për aplikimet e plota, të depozituara në kohë dhe që plotësojnë kërkesat dhe kriteret, Komisioni depoziton propozim pranë kryetarit të Qytetit të Shkupit për përzgjedhjen e aplikantit/ve për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e projektit/ve.

8.4. Kryetari i Qytetit të Shkupit, me propozim të Komisionit, miraton Aktvendim për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e projekteve.

8.5. Kandidatët e përzgjedhur do të lidhin kontratë me Qytetin e Shkupit me të cilën do të rregullohen të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellta.

8.6. Aplikantët e përzgjedhur nuk kanë të drejtë të ndryshojnë aktivitetet programore dhe afatin kohor për realizimin e tyre, të përshkruara në projektin për të cilin kanë aplikuar, përveç me pëlqimin paraprak të Qytetit të Shkupit.

8.7. Aplikantët që kanë marrë mjete financiare nga Qyteti i Shkupit për realizimin e projekteve të tyre janë të detyruar ta përfundojnë projektin dhe të depozitojnë raport financiar për mënyrën e realizimit të tyre të dedikuar me kopje të dokumenteve financiare përkatëse pranë kryetarit të Qytetit të

Shkupit në formular të shpallur në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit jo më vonë se data 3 dhjetor 2026.

## **9. Afati dhe mënyra e depozitimit të aplikimeve**

9.1. Afati i fundit për depozitimin e aplikimeve është 15 ditë nga data e shpalljes së Thirrjes Publike në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit. ([www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk)).

9.2. Kërkesa me të gjithë dokumentacionin e plotësuar në mënyrë elektronike, e nënshkruar dhe e vërtetuar/vulosur nga personi përgjegjës i aplikantit duhet të depozitohet në zarf të mbyllur me postë në adresën: Qyteti i Shkupit, bul. "Ilinden" 82, me shënimin: Sektori për bashkëpunim ndërkombëtar dhe mbështetje të shoqatave dhe fondacioneve - Komisioni për projekte dhe aktivitete programore të shoqatave dhe fondacioneve me interes për Qytetin e Shkupit ose përmes Arkivit të Qytetit të Shkupit çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në orën 16:00.

9.3 Aplikantët e Thirrjes publike do të njoftohen për rezultatet në një afat prej 10 ditësh nga dita e miratimit të Aktvendimit për ndarjen e mjeteve financiare.

9.4. Aplikimi për mbështetje financiare për projekte dhe aktivitete programore të shoqatave dhe fondacioneve dhe formulari i propozim - projektit janë në dispozicion në ambientet e Qytetit të Shkupit - Sektori për bashkëpunim ndërkombëtar dhe mbështetje të shoqatave dhe fondacioneve dhe në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit. ([www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk)).

9.5. Informacione më të hollësishme të interesuarit mund të marrin në adresën e-mail të mëposhtme: [saranda.bekiri@skopje.gov.mk](mailto:saranda.bekiri@skopje.gov.mk) ose në telefonin 02/ 3207 525.

### **VËREJTJE:**

***Aplikimet me dokumentacion të paplotë ose aplikimet e depozituara pas afatit të caktuar nuk do të shqyrtohen.***

***Shtojcat e depozituara nuk kthehen.***

**Kryetari i Qytetit të Shkupit  
Orce Gjorgjievski**

---